



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PLANI VJETOR I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË
PËR VITIN 2012**

Dhjetor, 2011

Parathënie.....	3
Hyrje (synimi, qëllimet dhe objektivat).....	4
Janar, shkurt, mars	5
prill, maj, qershor	6
korrik, gusht, shtator.....	7
tetor, nëntor, dhjetor.....	8
Përfundim.....	9

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Punën dhe aktivitetin e vet e mbështetë në LVL, Statutin e Komunës dhe në akte tjera nënligjore. Po ashtu siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të kuvendit, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave, siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Gjithashtu krijon mundësi për qytetarë që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Parimi kryesor dhe i përhershëm është barazia, demokracia dhe qeverisja e mirë.

Kuvendi i komunës, nxjerr akte të rëndësishme për komunën siç janë:

- ❖ Statuti i Komunës;
- ❖ Rregulloren e Punës;
- ❖ Rregulloret komunale dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim normal të komunës.

Përpos këtyre akteve, kuvendi i komunës, kryen edhe funksione tjera dhe detyra të padeleguara:

- ❖ Miraton planin vjetor të punës;
- ❖ Themelon komisione sipas ligjit;
- ❖ Merr vendim për krijimin dhe përdorimin e dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- ❖ Bën emërimin, riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
- ❖ Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- ❖ Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacionet përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës dhe përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Hyrje

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012

Plani i Punës i Kuvendit është dokument njëvjeçar i hartuar, dhe i bashkërenditur me aktivitetet e planit të punës së kryetarit të komunës dhe i aprovuar nga kuvendi i komunës. Plani i Punës, përmbledh punën njëvjeçare të kuvendit të komunës duke përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet, ndërsa çështjet të cilat nuk mund të planifikohen, dhe dalin si nevoja për shqyrtim në kuvend do të trajtohen sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, Statutit dhe LVL. Në këtë mënyrë në planin e punës janë paraparë 10 mbledhje të rregullta, të cilat do të mbahen të enjten e fundit të muajit, duke filluar në orën 10:00, përveç mbledhjes së muajit shtator, e cila do të mbahet në pjesën e parë të këtij muaji.

Plani i Punës është i bazuar në objektiva, qëllime dhe synimin e kuvendit të komunës.

Synimi:

- Një përfaqësim dinjitoz ku do të realizohen interesat e qytetarëve!

Qëllimet:

- Të trajtohen çështjet që janë në interes të qytetarëve;
- Të vëhen konturat e punës vjetore të kuvendit;
- Të rritet pjesëmarrja e anëtarëve të kuvendit në diskutime me qëllim të përfaqësimit të interesave të qytetarëve;
- Të futet në kuvend frymë-demokratike dhe një debat i shëndoshë dhe i dobishëm;
- Të mos ketë në kuvend debate të panevojshme dhe papërgatitje;
- Të merren vendime që janë në interes për qytetarë dhe të kontrollohet zbatimi i tyre.

Objektivat:

Objektivat e Planit të Punës së Kuvendit janë:

- Identifikimi i nevojave të domosdoshme për trajtim në kuvend;
- Ndarja e punëve dhe aktiviteteve dhe vendosja e tyre në planin e punës;
- Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë anëtarët e kuvendit;
- Respektimi i Planit të Punës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit;
- Rritja e transparencës.

Trajtimi i çështjeve në mbledhjet e KK-së gjatë vitit kalendarik 2012:

Janar:

- ❖ Raport për punën e Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2011 (kryesuesi i kuvendit);
- ❖ Propozim-vendim për hartimin e planit rregullues nga fshati Smrekonicë deri në fshatin Gracë konform planit zhvillimor (Drejtoria për Urbanizëm);
- ❖ Propozim-vendim për emërimin e bordit këshillëdhënës për hartimin e planit rregullativ të komunës (Drejtoria për Urbanizëm);
- ❖ Raport vjetor i punës së Komitetit për Komunitete;
- ❖ Raport vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Ekonomi dhe Shërbime Publike;
- ❖ Raport vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Shkurt:

- ❖ Informatë për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2011 (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2011/2012 (Drejtoria për Arsim);
- ❖ Propozim- vendim për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për shërbimet e varrimit (Drejtoria për Shërbime Publike);
- ❖ Raport vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Rini dhe Sport;
- ❖ Raport vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- ❖ Draft-rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës (Drejtoria për Administratë);
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

17 Shkurti-Dita e Pavarësisë e Republikës së Kosovës. Anëtarët e kuvendit do të jenë të njoftuar me kohë për të gjitha aktivitetet që do të mbahen në rastin e shënimit të Ditës së Pavarësisë.

Mars:

- ❖ Informatë mbi ndërtimet dhe parandalimet e ndërtimeve të egra në Komunën e Vushtrrisë (Drejtoria për Inspektime);
- ❖ Propozim-vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi

- për transfere dhe subvencione për entitetet publike dhe jopublike (Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale);
- ❖ Raport për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në vitin 2011 (kryetari i komunës);
 - ❖ Raport vjetor i punës së KKSB-së.
 - ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

- a) 5,6,7 Marsi-Epopeja e UÇK-së;
- b) 7 Marsi-Dita e Mësuesit;
- c) 8 Marsi-Dita e Nënave;
- d) 24 Marsi-përvjetori i fillimit të sulmeve të NATO-s kundër pozicioneve të forcave serbe.

Prill:

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt; janar, shkurt, mars 2012 (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Propozim- vendim për racionalizimin e përdorimit të ujit të pijshëm nga rrjeti i ujësjellësit të komunës (Drejtoria për Shërbime Publike);
- ❖ Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Draft-rregullore për ndarjen e mirënjohjeve dhe plaketave për Ditën e Çlirimit (Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport);
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Maj:

- ❖ Propozim- vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Sigurinë në Komunikacion në territorin e Komunës së Vushtrrisë (Drejtoria e Shërbimeve Publike);
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

- a) 2 Maji-Akademi përkujtimore për rastin e përvjetorit të masakrës së Studimes;
- b) 9 Maji-Akademi për rastin e Ditës së Evropës;
- c) 22 Maji-Akademi përkujtimore;
- d) 26-27 Maji-Takimet e Poeteshave Shqiptare.

Qershor:

- ❖ Informatë mbi përgatitjet për fushatën e korrje-shirjeve (Drejtoria për Ekonomi);
- ❖ Qarkorja buxhetore(fillimi i planifikimit të buxhetit) Drejtoria për Buxhet dhe Financa;

- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

- 17 Qershori-Dita e Çlirimit të Vushtrrisë. Anëtarët e kuvendit do të jenë të njoftuar me kohë për të gjitha aktivitetet që do të mbahen për rastin e Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë;
- Tubimi i parë me qytetarë në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012. Pjesëmarrës në panel: kryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit, nënkryetari/ja, drejtorët e drejtorive dhe anëtarët e kuvendit.

Korrik:

- ❖ Raport për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012 (kryetari i komunës);
- ❖ Shqyrtimi i parë i Draft-rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2013(Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Informatë për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: prill, maj dhe qershor 2012 (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

Takim me mërgimtarë.

Gusht:

- ❖ Muaj i pushimeve verore.

Shtator: mbledhja do të mbahet me 13 shtator.

- ❖ Propozim-Vendim për aprovimin e buxhetit dhe projekteve investuese për vitin 2012 (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Shqyrtimi i dytë i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2012 (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2011/2012 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2012/2013 (Drejtoria për Arsim);
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

- Një Shtatori-Dita e Dëshmorëve të Kombit në Komunën e Vushtrrisë;
- Vizitë për anëtarët e kuvendit në Republikën e Shqipërisë;
- Organizimi i punëtorisë me anëtarët e kuvendit për hartimin e planit të punës së kuvendit.

Tetor:

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: korrik, gusht dhe shtator 2012 (Drejtorja për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

Manifestimi i ditës së patates në Komunën e Vushtrrisë.

Nëntor:

- ❖ Raport-pune nga Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- ❖ Informatë lidhur me shërbimet publike: furnizim me ujë, pastrim të mbeturinave dhe të ambientit (Drejtorja për Shërbime Publike);
- ❖ Informatë lidhur me mirëqenien sociale: strehimi familjar, përkujdesja për të moshuarit (Drejtorja për Shëndetësi);
- ❖ Informatë lidhur me standardet e ndërtimit të objekteve shumëkatëshe (Drejtorja për Urbanizëm);
- ❖ Informatë lidhur me numrin e bizneseve aktive dhe pasive (Drejtorja për Buxhet dhe Financa);
- ❖ Informatë lidhur me mbrojtjen e ambientit, pronave, lumenjve dhe të pyjeve (Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim);
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

28 Nëntori-Dita e Flamurit.

Dhjetor:

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake për muajt, tetor, nëntor 2012;
- ❖ Propozim-Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013;
- ❖ Trajtimi eventual i çështjeve tjera të proceduara për kuvend.

Aktivitetet:

Tubimi i dytë me qytetarë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012. Pjesëmarrës në panel: kryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit, nënkryetari, drejtorët e drejtorive dhe anëtarët e kuvendit.

Përfundim

Plani Vjetor i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë do të ndihmojë dhe lehtësoi punimet e mbledhjeve të kuvendit të komunës. Duke iu ofruar anëtarëve të kuvendit Planin e Punës, ata do të kenë një pasqyrë për të gjitha punët dhe aktivitetet të cilat kanë mundur të planifikohen për vitin 2012.

Edhe pse në planin e punës janë paraparë 11 mbledhje të rregullta, sipas nevojës, mund të mbahen edhe mbledhje të jashtëzakonshme konform LVL-së.

Vushtrri, Dhjetor 2011

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi